

TERMAT E REFERENCËS

DETYRË PROJEKTIMI

Për objektin: **Studim projektim "Rikonstuksion i Qendrës Kulturore të Fëmijëve "Meleq Staravecka", Çorovodë."**

Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Bashkia Skrapar kërkon të realizojë, projektin e plotë për: *"Rikonstuksion i Qendrës Kulturore të Fëmijëve "Meleq Staravecka", Çorovodë"*.

I. PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE


- **Vendndodhja:** Objekti i **Qendra Kulturore e Fëmijëve "Meleq Staravecka**, ndodhet në adresën: Rruga "RINIA" nr.19, 5401, Çorovodë, SKRAPAR.
- **Gjendja e egzistuese:** Qendra Kulturore e Fëmijëve "Meleq Staravecka", Çorovodë, është një ndërtesë 2 katëshe, me dy seksione. Në njërin nga seksionet janë ambjentet e zyrave dhe kurseve, ndersa në seksionin tjetër ndodhet salla e shfaqjeve me skenën dhe ambjentet ndihmese të skenës si dhe dhoma e projektimit. Dy seksionet lidhen në mes nga holli i sallës së shfaqjeve. Nyja hidrosanitare është në katin -1 në seksionin 2 katësh ku ndodhen zyrat.

Sipërfaqet e ndërtimit sipas kateve, janë si më poshtë:

kati përdhe.....	550	m ²
kati i parë (pa mbingritjen e sallës)	207	m ²
TOTALI	757	m²

- Dyshemetë janë plotësisht të amortizuara
- Dyert janë plotësisht të amortizuara dhe të dëmtuara.
- Dritaret janë duralumin, por shumë të amortizuara së bashku me davancialet.
- Suvatimet e brendëshme janë të dëmtuara për shkak të lagështisë.
- Sistemi i ngrohjes dhe ventilimit mungon, si në sallën e shfaqjeve ashtu dhe në ambjentet e tjera.
- Ambjentet ndihmëse të sallës së shfaqjeve (dhomat e artistëve) nuk kanë elementë hidrosanitarë.
- Instalimet elektrike krejtësisht të amortizuara.
- Nyja hidrosanitare është në katin -1 në seksionin 2 katësh ku ndodhen zyrat. Është shumë e amortizuar në të gjithë elementët e saj.
- Hidroizolimi i soletës është në gjendje të mirë pasi është realizuar kohët e fundit.
- Suvatimi i jashtëm është granil me çukitje, krejtësisht i amortizuar dhe nuk siguron termoizolim të mirë për objektin.
- Ambjentet e jashtme janë të pa sistemuara.

Pozicionimi sipas frgmentit të hartës kadastrale



Pozicionimi sipas fotos dixhitale në ASIG



II. QELLIMI

Nëpërmjet kësaj detyre projektimi, synohet të realizohet projekti i **Rikonstuksionit të godinës së Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Meleq Staravecka”, Çorovodë.**

Qëllimi kryesor i Detyrës së Projektimit është studimi i të gjithë elementeve të objektit, në mënyrë që të evidentohen të gjitha problematikat e tij, dhe më pas të parashikohet zgjidhja e tyre, për të krijuar një gjendje sa më optimale të objektit për kthimin e tij në një qendër bashkëkohore për zhvillimin dhe argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve. Më poshtë po përshkruajmë çështjet kryesore, që parashtrihen për zgjidhje:

- Rifreskimi total i shtresave të dyshemesë.
- Zëvendësimi i të gjitha dyerve.
- Zëvendësimi i të gjitha dritareve përfshirë davancialet.
- Rikonstrukcioni i përgjithëshëm i sallës së shfaqjeve dhe skenës, shtresat dhe veshjet, instalimet elektrike dhe ato të fonisë, sistemin ngrohës dhe ventilues si dhe mobilimin.
- Rikonstrukcionin komplet të nyjes hidrosanitare egzistuese, si dhe mundësimi i krijimit të një nyje hidrosanitare të re në ambjentet ndihmëse të sallës së shfaqjeve (dhomat e artistëve)
- Rifreskimin e suvatimeve të brendëshme.
- Instalimet elektrike dhe hidraulike të objektit.
- Aplikimi i sistemit kapot, në të gjitha fasadat e objektit, me qëllim përmirësimin e termoizolimit dhe kursimin deri në 50% të konsumimit të energjisë, që nevojitet për ngrohjen e ambjenteve të brendëshme.
- Sistemimi i ambjentit të jashtëm.

III. FAZAT E SHËRBIMEVE

Për të realizuar me sukses qëllimin e kësaj detyre projektimi, projektuesit i kërkohet të kalojë në këto faza shërbimesh, në zbatim të VKM-së nr.355 datë 11.05.2016 "Manuali i tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", neni 25.

1. FAZA II: Projekt-ide paraprake
2. FAZA III: Projekt-ide përfundimtare
3. FAZA V: Projekt i Zbatimit
4. FAZA VI: Preventivi përfundimtar

Sipas fazave të mësipërme, në zbatim të VKM-së nr.355 datë 11.05.2016, projektuesi do paraqesë zgjidhjet e çështjeve të përshkruara në pikën II, për FAZËN II: Projekt-ide paraprake dhe FAZËN

III: Projekt-ide përfundimtare, për dakortësim dhe miratim nga Autoriteti Kontraktor, përpara se të kalojë në fazat e tjera.

IV. AFATET PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

Afati për Studim projektim “ Rikonstuksionit të godinës së Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Meleq Staravecka”, Çorovodë.” do të jetë **4 (katër) muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

V. REALIZIMI I PROJEKTIT

5.1 Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi.

Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

5.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi do të përdorë programet e kërkuara kompjuterike.

Në raportin teknik të sqarohen investigimet e bëra nga projektuesi për gjendjen egzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit. Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes, specifikimet teknike për materialet si dhe proceset e punimeve që do të kryhen, vizatimet ku do të ndërhyet (planimetri, prerje, hollësi ndërtimore, detaje teknike etj), si dhe volumet kryesore të punimeve dhe materialeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje.

VI. Projekti i zbatimit

Projekti i zbatimit për “Rikonstuksionit të godinës së Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Meleq Staravecka”, Çorovodë” duhet të përmbajë:

- Projekti Arkitektonik (përfshirë mobilimin).
- Projekti elektrik
- Projekti hidroteknik
- Projektin e mbrojtjes nga zjarri
- Projekti i ngrohjes dhe ventilimit (në varësi të zgjidhjes së miratuar).
- Raportin Teknik

- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen
- Grafikun e punimeve (me kohën e punës për çdo zë punimesh).
- Preventivin e punimeve sipas modelit të Pltaformës “*Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim*”, SiM të Ministrisë së Infrastruturës dhe Energjisë”, shoqëruar me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në sistem.

VII. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

- Planimetritë e zonave të ndërhyrjes në objekt në format jo më të vogël se A3
- Planorganizimi i punimeve në format jo më të vogël se A3
- Hollësi dhe detaje të tjera teknike në format jo më të vogël se A3
- Relacioni teknik, specifikimet teknike, grafiku i punimeve dhe preventivi me dhe pa çmime, në format A4.

VIII. Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me objektin.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Institucionet shtetërore si Sektori i Planifikimit të Territorit, Arshiva dhe nga Kadastra e Bashkisë Skrapar .
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

VIII. Dorëzimi i Projektit

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale të printuara, si dhe në version të dixhitalizuar në 2 (dy) CD, ku një CD do të përmbajë punimet në DWG, Office Word-Excel, dhe një CD do të përmbajë të gjithë dokumentacionin në format PDF me vulë elektronike.

I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht sipas kërkesave për pajisje me leje ndërtimi të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

Skrapar, më 05.03.2025